

KËRKIME GJUHËSORE

Bahri KOSKOVIKU

KLASIFIKIMI I FJALISË SË PËRBËRË ME NËNRENDITJE

Problemi i klasifikimit të fjalisë përbërë me nënrenditje në gramatikat shqipe ende nuk konsiderohet i zgjidhur mirë, për shkak të shumë problemeve që dalin në rrafshin praktik, sidomos kur është fjala për paralelizmin funksional që ngrihet midis fjalisë së nënrenditur dhe një gjymtyre të fjalisë së thjeshtë, si një koncept logjik, teori mbi të cilën është trajtuar kjo çështje shkencore. Theksi i këtyre problemeve vihet re sidomos tek fjalitë lidhore duke përfshirë edhe lidhëzoret.

Në gramatikat shqipe baza e vështimit të problemit mbështetet nga kritere të ndryshme që vijnë varësisht nga ajo se çfarë konsiderohet më e rëndësishme në klasifikimin e tyre, cili është ai tipar themelor, që do t'i përshkruante sa më mirë raportet fjali kryesore-fjali e varur, që do shërbente si kriter bazë për ndarjen e tyre në klasa dhe nënklasa dhe do të rezultonte me një ndarje homogjene mbi bazën e tipareve të përbashkëta strukturore, semantike dhe funksionale.

Lidhur me këtë problematikë deri më tani janë përdorur tri kritere tashmë të njohura në sintaksat shqipe: kriteri që bën paralelizmin midis fjalisë varur dhe një gjymtyre të fjalisë së thjeshtë i njohur si *kriteri funksional*, kriteri semantiko-strukturor, që në plan të parë vë semantikën e frazës dhe kriteri strukturor-semantik që merr parasysh një sërë faktorësh strukturorë në klasifikimin e fjalisë së përbërë me nënrenditje.

Duke mos u futur më thellë se gjysma e dytë e shekullit XX, atëherë kur studimet sintaksore në shqipe u kristalizuan më qartë edhe nga pikëpamja teorike, brenda vështimit tonë janë marrë në konsideratë lidhur me këtë dukuri problemore disa nga gramatikat më të përdorura gjatë dekadave të fundit, që janë shprehëse e qartë e këtij koncepti, si: *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2*, grup autorësh, botim i ASHASH-së, Tiranë, 2002, *Sintaksa e gjuhës shqipe* e Stefan Priftit, ETMMK, *Sintaksa e gjuhës shqipe* e Mahir Domit, ETMM i Kosovës, studimi i Spiro Floqit “Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme”, “Fraza me nënrenditje”, Tiranë, 2000 e M. Totonit dhe së fundmi “*Gjuha shqipe (sintaksa)* nga Thoma Dhima.

Pikëpamjet e paraqitura në *Gramatika e Gjuhës shqipe 2*, botim i Akademisë rreth kësaj çështjeje përbëjnë variantin më të ngjeshur të teorisë sintaksore në shqipe nga aspekti praktik që merr për bazë analogjinë e dy rrafsheve të ndryshme sintaksore: togfjalëshit dhe fjalisë përbërë, teorikisht e njohur si *kriteri funksional*.

Në rrafshin teorik, i prirë nga drejtimi logjiko-semantik, problemi vështrohet si një unitet dialektik i përmbajtjes me formën¹. Pra pikënisja e zgjidhjes së problemit në rrafshin teorik është një logjikë kuptimore, një

¹ Grup autorësh, *Gramatika e gjuhës shqipe 2*, ASHSH, Tiranë, 2002, f. 495.

paralelizëm logjik i mbështetur në përmbajtje, që në rrafshin praktik, siç do të shihet më vonë nuk del të jetë i realizuar plotësisht dhe si i tillë jo shumë i suksesshëm, meqë nuk vë në dukje në plotëni kompleksitetin e frazës, përkundrazi e kufizon studimin e saj vetëm në funksionin e fjalisë së nënrenditur në raport me kryesoren, duke lënë anash aspekte tjera që janë themelore për kuptimin e saj, madje çon edhe në zgjidhje të gabuara për të cilat do të flitet më poshtë. Sintaksologët tanë mundësinë e zbatimit të koncepteve strukturaliste në gramatikat shqipe e përjashtojnë, duke e parë atë si të papërshtatshëm, duke e lidhur këtë me natyrën e veçantë të gjuhës shqipe, mendohet në natyrën flektive të saj. Por në rrafshin praktik në çfarë mbështetet jopërshtatshmëria e klasifikimit të fjalisë përbërë me nënrenditje sipas mjeteve të lidhjes i konceptuar në gramatikat shqipe si aspekti formal? - Ka vetëm një argument të qartë që e arsyeton këtë “papërshtatshmëri” në rrafshin praktik e kjo është polisemia e lidhëzave.

Lidhur me këtë Domi thoshte “Marrja parasysh e mjeteve sintaktike të fjalive të nënrenditura është e domosdoshme, por ajo s’mbafton për t’i karakterizuar ato.”² Domi argumenton edhe më tej bindjet duke thënë se edhe vetë lidhëzat nuk mund të grupohen sipas kuptimit të tyre për shkak të polisemisë.

Në përgjithësi, edhe Prifti ka po këto qëndrime me ndonjë argument shtesë lidhur me këtë çështje. Sipas tij “Klasifikimi i fjalive si çdo klasifikim shkencor, do të jetë rezultat i ndarjes së tyre në grupe **homogjene** në bazë të një tipari apo aspekti kualitativ, i cili përbën themelin e ndarjes”³, që do të thotë se aspekti funksional është ai tipar që i jep një karakter homogjen ndarjes së fjalive me nënrenditje.

Prifti për këtë si argument shton e dhe faktin se disa grupe fjalish siç janë fjalitë asindete “...s’mund të studiohen më tej veçse në baza funksionale”⁴. Ai përjashton ndarjen e mundshme formale duke parë edhe ky si shkak kryesor poliseminë e lidhëzave. Siç dihet, ajo që është e re tek Prifti, që veçimi i fjalive ndajshimore si grup i veçantë, duke i ndarë veç fjalitë cilësore (mbiemërore). Në fakt, sipas pikëpamjes sonë, polisemia e lidhëzave jo që nuk është pengesë për një ndarje me bazë strukturore, duke u fokusuar tek mjetet e lidhjes (jo tek fjala mbështetëse sikurse Totoni), por, ajo në mënyrën siç interpretohet, nuk ekziston fare. P.sh. lidhëzat semantike *kur* e *ku* përveç në fjalitë lidhëzore-kohore e lidhëzore-vendore, që janë përcaktuese të raporteve, përdoren edhe në fjalitë lidhëzore-kundrinore, si: *E sheh ku e ka gabimin. Nuk e mbante mend kur e kishte shkruar poezinë e parë* (Gramatika e gjuhës shqipe 2, f. 520). Në shembujt e dhënë lidhëzat *ku* e *kur* nuk janë ato që përcaktojnë raportet sintaksore të fjalisë së nënrenditur me kryesoren, sepse kontekstualisht ato nuk janë lidhëza semantike, por asemantike, funksionalisht fthilluese; është kuptimi kalimtar e vepror i foljes që kërkon një kundrinë të drejtë e që përcakton raportet sintaksore midis tyre dhe jo lidhëzat *ku* e *kur*.

² M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, ETMMK, PRISHTINË, 1971, f. 65.

³ Stefan Prifti “*Sintaksa e gjuhës shqipe*” f. 253, Enti i teksteve..., Prishtinë, 1971.

⁴ Po aty.

KLASIFIKIMI I FJALISË SË PËRBËRË ME NËNRENDITJE

Ndërsa S. Floqi është i pari nga gramatikanët tanë që jep një qasje më ndryshe ndaj këtij problemi sintaksor në artikullin e tij “Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur në shqipen e sotme”⁵. Ai në plan të parë vuri karakterin e raporteve sintaksore midis fjalisë kryesore dhe fjalisë së varur prej saj, ndonëse korrelatin e vuri si kriter kryesor në grupimin e tyre. Gjithë fjalitë i ndau në dy grupe të mëdha: fjali korrelative (me korrelat të domosdoshëm), fjali jokorrelative (fjali që s’mund të marrin korrelat) dhe fjalitë fakultativisht korrelative. Jashtë këtij klasifikimi mbetën fjalitë përcaktore dhe disa tipa të fjalive rrethanore. Kështu që ky klasifikim, në radhë të parë, është jo i plotë dhe nuk u aktualizua shumë në qarqet shkencore të kohës.

Totoni, duke bërë një varg vërejtjesh për këtë mënyrë grupimi të fjalive të nënrenditura, merr parasysh një sërë faktorësh strukturorë, roli i të cilëve është vendimtarë në organizimin strukturor dhe kumtesor të frazës së përbërë me nënrenditje. Studimet e Totonit për këtë çështje konsiderohen avancime të teorisë sintaksore në përgjithësi. Totoni, ndonëse e analizoi gjerësisht fjalinë e përbërë në rrafshin strukturor, si kriter kryesor zgjodhi *fjalën mbështetëse* (paraprisin), por ndarja e rubrikave, mbështetur në shumë faktorë e bën disi të thërrmuar dhe jo shumë praktike këtë ndarje. Megjithatë Totoni bëri një hap të madh për t’i lëvizur gjërat në kuptimin teorik dhe metodologjik në sintaksat shqipe, të cilat që nga vitet 70-ta mbetën pothuajse në pikën statike.

Kurse botimi i fundit i Thoma Dhimës “Gjuha shqipe (sintaksa)” në këtë plan nuk paraqet asgjë të re, sikur e thotë vetë klasifikimi i fjalive të përbëra me nënrenditje është një variant i përafërt me atë të Akademisë. Ai fjalitë e përbëra me nënrenditje i ndan në tri rubrika duke vënë në plan të parë herë kuptimin, herë funksionin: fjalitë ftilluese, fjalitë përcaktore dhe fjalitë rrethanore. Të vetmin ndryshim e shoh në faktin se fjalitë kundrinore, kryefjalore dhe disa tipa fjalish kallëzuesore i fut në një rubrikë dhe i quan fjali ftilluese, gjë që nuk është e re, meqë një ndarje të tillë është bërë më parë edhe nga Totoni. Duken interesante vlerësimet e tij lidhur me këtë problematikë kur thotë se kriteri i fundit i zbatuar pas viteve 90-ta (kriteri strukturor-semantik i zbatuar nga Totoni – v.j) është pa dyshim më i miri, sepse lejon të zbulohen të gjitha veçoritë strukturore dhe semantike të frazës⁶. Më vonë, thotë se kriteri funksional është më i përdorshmi e diku më i pranueshmi dhe i mbahet kësaj vije në trajtimin e kësaj problematike.

Viteve të fundit edhe Linditë Rugova në një artikull shkencor, “Klasifikimi i periudhës me nënrenditje në gramatikat shqipe të gjysmës së parë të shekullit XX” e trajton këtë problematikë në planin teorik duke konstatuar se të gjitha sintaksat shqipe mbështeten në kriterin logjik dhe, duke bërë vërejtje për këtë, kërkon që kjo çështje, të mos lihet nën hijen e traditës dhe të sintaksologëve të shquar të shekullit XX.⁷

⁵ “Konferenca e parë e studimeve albanologjike”, Tiranë, 1965.

⁶ Thoma Dhima, *Gjuha shqipe* (Sintaksa), f. 152, "Libri universitar", Tiranë, 2005.

⁷ L.Rugova, “Seminari ndërkombëtar” 23/1, Prishtinë 2004, f. 440.

Kjo teori sintaksore që ka për bazë këtë analogji funksionale nuk konsiderohet as nga sintaksologët tanë që ishin zbatuesit dhe promovuesit e këtij koncepti, si zgjidhja më e mirë, as si zgjidhja më e drejtë shkencore, por si zgjidhja më e përshtatshme. Në fakt, problemi shtrohet se a është aspekti funksional një tipar që do të rezultonte një ndarje homogjene siç pretendon Prifti, ku raportet sintaksore do të jepeshin në mënyrë të sistematizuar e të përgjithësuar siç thuhet në Gramatika e Gjuhës Shqipe 2 botim i ASHASH-së, kur dihet se aspekti funksional si koncept është heterogjen dhe ky heterogjenitet funksional nuk mund të bëjë një ndarje homogjene. Mbi cilën bazë do të mundë të quhej homogjene ta zëmë klasifikimi i fjalive lidhore (përfshirë edhe fjalitë lidhëzore), kur merret parasysh baza e tyre strukturore, skema ndërtuese e tyre dhe vënia në një grup e fjalive me stukturë të ndryshme. Në vijim kemi marrë disa shembuj në gramatikat e sipërpërmendura që vë në dukje mënyrën e klasifikimit të fjalive të përbëra me nënrenditje, bazën e tyre teorike në të cilën është mbështetur kjo ndarje dhe vështirësitë që lindin në rrafshin praktik si pasojë e qartë kësaj mënyre të klasifikimit të tyre sipas **kriterit funksional**:

Ne u themi se atdheu ynë është i bukur. (ASHSH, f. 516-518)

A) *Ç'të mbjellësh, do të korrësh.*

Thuaj cili je se po e vras mendjen e s'e gjej dot.

Kur e shikon shoferin që tregon kujdes, të vjen ta lavdrosh.

Të gjitha këto fjali, të cilat nga pikëpamja strukturore janë krejtësisht të ndryshme, nga aspekti funksional janë të ngjashme, në gramatikat shqipe, janë grupuar brenda një rubrike dhe janë pjesë e kapitullit "Periudha me fjali të varur kundrinore". Nëse i referohemi bazës së tyre strukturore, fjalia e parë është lidhëzore dhe kuptimisht fillon kuptimin e një foljeje në fjalinë kryesore; fjalia e dytë është e tipit përemëror joanaforik; fjalia e tretë është fjali e pyetjes së zhdrejtë për shkak të skemës së veçantë ndërtuese që e ka, trajtohet si një grup i ndarë dhe fjalia e katërt është lidhore e mirëfilltë e tipit anaforik. Pra fjalitë e tilla me përbërje strukturore të ndryshme janë vënë në një grup, kurse fjalitë si këto të marra nga botimi i Akademisë:

Dokës i ra menjëherë në sy se Marku ish ligur mjaft (ASHASH).

B) *Rrëfejnë se në njërin prej atyre viteve u bë një thatësi e madhe.*

Ata shfaqën mendimin se djali mund të shërohej.

nga baza funksionale janë të ndryshme: e para është kryefjalore, e dyta është kundrinore, e treta përcaktore, por nga ana strukturore janë të njëjta që të tria janë fjali lidhëzore ftilluese, në të cilat fjalia e varur ftillon kuptimin e një foljeje (fjalia e parë dhe e dytë), gjegjësisht të një emri abstrakt të pakonkretizuar si përmbajtje (fjalia e tretë) në fjalinë kryesore.

Nga sa shihet fjalitë me struktura të ndryshme vihen në një grup të përbashkët sikur në rastin e parë, ndërsa fjalitë me struktura të njëjta vihen në grupe të ndryshme, siç shihen nga shembujt e dhënë në rastin e dytë. Një vërejtje të tillë e gjejmë edhe te M. Totoni rreh kësaj problematike në librin e tij "Fraza me nënrenditje" Në fakt, në arsyetimet teorike në gramatikat e mësipërme mungon diçka themelore: të kuptuarit e problemit në thelb, vënia në dukje e atyre tipareve

KLASIFIKIMI I FJALISË SË PËRBËRË ME NËNRENDITJE

strukturore dhe funksionale-semantike që do të vinte në dukje natyrën e veçantë të çdo tipi fraze e kjo nuk arrihet duke vënë në plan të parë teorinë e gjymtyrëzimit logjik të fjalisë së varur në raport me fjalinë kryesore. Polisemia e lidhëzave tek fjalitë lidhore si i vetmi argument i shprehur në rrafshin praktik nuk përbën një arsytim për mosmarrje parasysh të mjeteve të lidhjes si pjesë e planit të parë. Duke mos marrë parasysh faktorët strukturorë tipikë të ndërtimit shpeshherë është i vështirë edhe interpretimi i kuptimit të frazës, p.sh:

Kushdo që i ka parë, ka mbetur i mahnitur. Pyet këdo që të duash. (Gramatika e gjuhës Shqipe 2, grup autorësh, Tiranë 2002), f. 525

Këto fjali interpretohen herë si kryefjalore, herë si kundrinore, herë si kallëzuesore të tërthorta, herë si përcaktore. Fjalitë e varura me nënrenditje trajtohen, nga ana kuptimore, herë si shtjellim i kryefjalës a kundrinës **kushdo** e **këdo** në fjalinë kryesore, herë si një konkretizim i tyre duke parë fjalinë e varur nga aspekti funksional si përcaktore. Pra dykuptimësia, inkoherenca dhe mungesa e një paralelizmi të plotë, teori mbi të cilën është ndërtuar ky koncept ndarjeje i fjalive lidhore në gramatikat shqipe e vështirëson edhe më kuptimin e tyre me këtë formë renditjeje të tyre.

Sipas mendimit tonë drejtimi logjik sintaksor në shqipe i bazuar në një analogji sintaksore të jashtme nuk i ka dhënë një përgjigje të drejtë kësaj problematike shkencore, për shkak të shumë kundërthënieve dhe pasaktësive që dalin në rrafshin praktik, për të cilat flasin edhe vetë Domi, Prifti e Totoni, probleme që janë theksuar qartë edhe në Gramatika e gjuhës shqipe 2, sikundër është rasti i fjalive kryefjalore që në pikëpamje kuptimore nuk kanë asgjë të përbashkët me kryefjalën; kryefjala është gjymtyrë kryesore në një fjali të thjeshtë, kurse në fjalinë e përbërë del në plan të dytë si fjali e varur, pastaj disa fjali të varura nuk i gjejnë përgjegjëset e tyre në fjalinë e thjeshtë siç është rasti me fjalitë rrjedhimore (nuk ka plotës rrjedhimi) apo anasjelltas plotësi i mjetit dhe i shoqërimit nuk i kanë gjegjëset e tyre në një fjali të përbërë, kur i shtohet kësaj edhe sinonimia sintaksore e fjalisë varur me një gjymtyrë të fjalisë së thjeshtë në kuptim të zëvendësimit të ndërsjellë ndërmjet tyre, bie fjala, fjalia e përbërë: *Dihet se toka rrotullohet rreth diellit*; mund të transformohet në një fjali të thjeshtë duke e zëvendësuar fjalinë e nënrenditur me një kryefjalë: *Dihet rrotullimi i tokës rreth diellit*, e cila është pjesërisht e mundur, por jo e plotë.

Për një ndarje dhe klasifikim të natyrshëm të fjalive të përbëra me nënrenditje në plan të parë duhet të merren mjetet e lidhjes, në plan të dytë baza funksionale-semantike apo semantike-funksionale. Sipas këtij koncepti, fjalitë e grupit **A**, në pikëpamje të klasifikimit, në planin funksional janë të ngjashme, por në planin strukturor janë të ndryshme. Duke vënë mjetet sintaktike në plan të parë dhe duke mos e parë poliseminë e lidhëzave si problem që ndërhyr në renditjen e tyre, shembujt e dhënë sipër nuk mund të futen në të njëjtin grup, ngase veçantitë e tyre strukturore (duke u parë si plan i parë) janë krejtësisht të ndryshme, kurse fjalitë e grupit **B**, në planin strukturor janë të ngjashme, që të tria janë lidhëzore- filluese, kurse në planin funksional janë të ndryshme: e para kryefjalore, e dyta

kundrinore dhe e treta përcaktore-ftilluese dhe si të tilla ato grupohen në një rubrikë të vetme, si fjali lidhëzore-ftilluese.

Nga aspekti teorik, ne zgjidhjen e shohim jo në relacionin përmbajtje-formë siç e parashtron gramatika e Akademisë, por në relacionin formë-përmbajtje. Kështu që fjalitë e përbëra me nënrenditje në tërësi i ndajmë në dy grupe kryesore: *a) në fjali lidhore (përemërore) dhe b) fjali lidhëzore*. Fjalitë lidhore-përemërore më tutje do të ndaheshin në dy nëngrupe të mëdha sipas karakterit dhe natyrës së mjeteve të lidhjes: në *fjali lidhore (përemërore) të mirëfillta* (tipi anaforik) që për mjete të lidhjes kanë fjalët lidhëse: përemrat lidhorë dhe ndajfoljet lidhore dhe *fjali lidhore jo të mirëfillta*⁸(tipi jo anaforik) që për mjete të lidhjes kanë përemrat lidhorë të pacaktuar dhe *fjalitë e pyetjes së zhdrejtë* që po ashtu për mjete të lidhjes kanë fjalët pyetëse (përemra dhe ndajfolje pyetëse). Natyrisht, secili grup pastaj mund të ndahet më tej në nëngrupe sipas karakteristikave të tjera potencialisht të rëndësishme për kuptimin e frazës, të cilat në këtë punim shkencor nuk gjejmë trajtëm më të gjerë; këtu bëhet fjalë për një ndarje në vija të përgjithshme. Grupin e dytë e përbëjnë: *fjalitë lidhëzore ftillëzuese*, të cilat sipas funksionit i ndajmë në tri nëngrupe: *fjali lidhëzore kryefjalore*, *fjali lidhëzore kundrinore dhe fjali lidhëzore përcaktore*. E përbashkëta e tyre janë në radhë të parë mjetet e lidhjes dhe kuptimi ftillues i tyre në raport me fjalën së cilës i referohen; dy grupet e para i referohen një foljeje, kurse nëngrupi i tretë, fjalia e varur i referohet një kategorie të caktuar të emrave abstraktë duke ftilluar kuptimin e tyre. Dhe së fundi *fjalitë lidhëzore rrethanore*: fjali lidhëzore vendore, kohore, qëllimore, shkakore, rrjedhimore, mënyrore, kushtore, lejore dhe krahasore. Në fjalitë e fundit një rol të drejtpërdrejtë e luan kuptimi i i fjalisë nënrenditur në raport me kryesoren.

Mendojmë se një ndarje e tillë e fjalive të përbëra në tërësi është më e thjeshtë, më e natyrshme, më homogjene dhe vë në dukje natyrën e veçantë të çdo tipi fraze mbi bazën e tipareve të përbashkëta strukturore dhe funksionale-semantike. Kjo eliminon dykuptimësinë e frazës së përbërë në kuptim të kategorizimit të saj si dhe mënjanon poliseminë si një arsyetim për interpretime të shumëfishta të kuptimit të frazës.

BIBLIOGRAFI

- ASHARSH, Instituti i Gjuhësisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I (Morfologjia)*, Tiranë, 1995.
- ASHARSH, Instituti i Gjuhësisë, *Gramatika e gjuhës shqipe II (Sintaksa)*, Tiranë 1997.
- ASHSH, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2 (Sintaksa)*, Tiranë, 2002.
- DOMI Mahir, *Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore..., Prishtinë, 1971.

⁸ Termi “jo të mirëfillta” është në kundërvënje me fjali lidhore të mirëfillta. Kjo ka të bëjë me karakterin e mjeteve të lidhjes.

KLASIFIKIMI I FJALISË SË PËRBËRË ME NËNRENDITJE

- PRIFTI Stefan, *Sintaksa e Gjuhës shqipe*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore..., Prishtinë, 1971.
- TOTONI Menella, *Fraza me nënrenditje*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2000.
- FLOQI S., ÇELIKU M., TOTONI M., PËRNASKA R., FLOQI S., *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe - Sintaksa e fjalisë*. Enti i teksteve..., Prishtinë 1971.
- FLOQI S., DOMI M., MANSAKU S., ÇELIKU M., PRIFTI S., *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe – Sintaksa e periudhës*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore ..., Prishtinë 1991.
- BECI Bahri, *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore ..., Prishtinë, 2001.
- CIPO Kostaq, *Gramatika dhe Sintaksa e Gjuhës Shqipe*, Instituti i Shkencave Tiranë, 1952.
 - “Klasifikimi strukturor – semantik i frazave me fjali të nënrenditur”, Studime filologjike, Nr. 2, Tiranë, 1990.
 - “Klasifikimi i fjalive të varura”, Studime filologjike Nr. 2, f. 137-151 Tiranë, 1972.
- XHUVANI Aleksandër, *Njohnit’ e para të sintaksës shqipe*, Tiranë 1938.
- SHEPERI Ilija Dillo *Gramatika dhe Sintaksa*, ASHASH, ribotim, Tiranë 2001.